



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 49, datë 25.09.2025

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "GODINA BANIMI DHE**  
**SHËRBIMI 5, 7, 10, 12, 14, DHE 15 KATE MBI TOKË, ME 2 KATE PARKIM**  
**NËNTOKË", NË SHKOZË, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Arb & Trans-2010" sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Godina banimi dhe shërbimi 5, 7, 10, 12, 14, dhe 15 kate mbi tokë, me 2 kate parkim nëntokë", në Shkozë, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Arb & Trans-2010" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarit vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



Nënshkruar më datë 02/02 2026